



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 27.11.2025
Numër Protokolli: 7683/2025

A.nr.1390/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1390/2025, të datës 17.07.2025, e plotësuar më datë 05.11.2025, të parashtruar nga ankuesja N.S, kundër organit të punësimit/Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 27.11.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1390/2025, e parashtruar nga ankuesja N.S.

II. Anulohet Vendimi me Nr.11-2/2025, i datës 16.07.2025, i Ministrit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

III. Detyrohet Ministri i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve që në zbatim të këtij vendimi emërimin e ushtruesit të detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të Inspektoratit Qendror të Punës ta bëjë në pajtim të plotë me ligjin material dhe pikëpamjet juridike si në arsyetimin e këtij vendimi, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra si në pikën III të dispozitivit.

A r s y e t i m

Ankuesja N.S(në tekstin e mëtejme referuar Ankuesja), më datë 17.07.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e plotësuar më datë 05.11.2025, kundër Vendimit Nr.11-2/2025, të datës 16.07.2025, të Ministrit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, lidhur me caktimin e ushtruesit të detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të Inspektoratit Qendror të Punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (tutje MFPT), ndërsa, kjo e fundit, ka përcjell dokumentacionin lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 4800/2025, të datës 17.07.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e ID-së së ankuses; Vendimin A.nr.4322025 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 22.07.2025 e dërguar për Udhëheqësin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve dhe Inspektoratit të Punës; Përgjigje në ankesë e datës 30.07.2025 e dërguar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve; Vendimin me Nr. 11-2/2025 të datës 16.07.2025, të Ministrit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve; Vendimi me Nr. 701-1/2025 i datës 26.05.2025, i Ministrit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve; Akt Emërimit me numër protokolli 38/2021 të datës 10.08.2021 të ankuses; Përgjigjen në ankesë e datës 29.08.2025 e dërguar nga Inspektorati i Punës; Akt Emërimit AE.Nr.NJB 87/2022 të datës 07.04.2022; Kërkesën e ankuses e datës 03.11.2025 për qasje në dokumente; Përgjigjen e datës 05.11.2025 për ankuesin nga Zyrtarja e Lartë për Komunikim me Publikun në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Plotësimin e ankese datë 05.11.2025.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se pretendimet ankimore janë të bazuara, **sepse:**

Nga administrimi i prove materiale të çështje rrjedhë:

-Ankuesja sipas Aktit të Emërimit me numër protokolli 38/2021, të datës 10.08.2021, është e punësuar në pozitën Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme në Inspektoratin Qendror të Punës.

- Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, më Vendimin me numër protokolli 701-1/2025, të datës 26.05.2025, ka caktuar Rizah Plakolli nga pozita Zyrtar Shpenzues dhe i Pasurisë në ushtrues të detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të Inspektoratit Qendror të Punës.

-Ankuesja me datë 17.07.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kundërshtuar ligjshmërinë e Vendimit me numër protokolli 701-1/2025, të datës 26.05.2025, të Ministrisë të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, për caktimin e ushtruesit të detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të Inspektoratit Qendror të Punës, duke pretenduar se ky vendim është në kundërshtim me nenin 35, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ngase ushtrues detyre në këtë pozitë nuk është caktuar zyrtari i kategorisë pasuese por është caktuar zyrtari që mban pozitë të kategorisë profesionale, duke më cenuar të drejtën time si kategori pasuese. Kërkon që të aprovet ankesa dhe të anulohet vendimi i kontestuar me ankesë.

-Në përgjigjen në ankesë Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve të datës 30.07.2025, ka përcjell Vendimin Nr.11-2/2025 të datës 16.07.2025, të Ministrit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, më të cilin vendimi është shfuqizuar Vendimi me Nr. 11-1/2025 i datës 26.05.2025.

-Ankuesja duke mos qenë në dijeni më faktin e nxjerrjes se aktit të ri lidhur më ushtruesin e detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të IQP-së, më datë 03.11.2025 ka parashtruar kërkesë pranë Këshillit për qasje në dokumente zyrtare rrjedhimisht ka kërkuar Vendimin Nr. 11-2/2025, të datës 16.07.2025, të Ministrit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

-Ankuesja më datë 05.11.2025, ka bërë plotësimin e ankesës me numër protokolli 4800/2025 të datës 17.07.2025, duke kontestuar ligjshmërinë e Vendimin me Nr. 11-2/2025 të datës 16.07.2025, të Ministrit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për caktimin e z. Rizah Plakolli ushtrues detyre i Drejtorit Ekzekutiv të Inspektoratit Qendror të Punës, më kërkesë që i njëjtit të anulohet.

Kolegji Këshillit lidhur me statusin juridik të Inspektoratit të Punës ju referua bazës ligjore si më poshtë:

I.Ligjit Nr.2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, me theks të veçantë: Neni 3.1 ku përcaktohet: *3.1 Inspektorati i punës si autoritet ekzekutiv themelohet nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe është përgjegjës para kësaj Ministrie në lidhje me koordinimin e veprimeve ekzekutive sa i përket Inspektorit të punës në Kosovë. Neni 4* ku përcaktohet se. *4.1 Kryeinspektori i punës udhëheq autoritetin e Inspektoratit të punës dhe është përgjegjës për zbatimin e detyrave që përmban funksioni i tij.... 4.4 Kryeinspektori i punës në veprimet e tij do të jetë i mbështetur nga zëvendësit me përgjegjësi për çështjet juridike, mbrojtje në punë dhe për çështje shëndetësore.*

II.Ligjit Nr. 017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës Nr. 2002/9, përkatësisht nenin 4, sipas të cilit neni 3 paragrafi 1 ri ligjit bazik riformulohet si vijon: *“Inspektorati i Punës themelohet nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Social dhe është përgjegjës para kësaj Ministrie në lidhje me koordinimin e veprimeve ekzekutive sa i përket Inspektoratit të Punës në Kosovë”.*

III.Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, sipas të cilit Inspektorati i Punës është Agjenci Ekzekutive. Gjegjesisht, sipas nenit 22 të këtij ligji parashihet se: *Drejtimi i Agjencisë Ekzekutive 1. Agjencia Ekzekutive drejtohet nga drejtori ekzekutiv. 2. Drejtori ekzekutiv i Agjencisë është nëpunës civil i kategorisë së lartë drejtuese sipas ligjit për zyrtarët publikë. 3. Drejtori ekzekutiv për performancën dhe veprimtarinë e Agjencisë, i përgjigjet ministrit dhe informon Sekretarin e Përgjithshëm.* Ndërsa me nenin 26 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji parashihet se: *1. Agjencia Ekzekutive dhe ajo Rregullatore organizohet si një apo disa departamente në bazë të fushë veprimtarisë. Niveli i organizimit përcaktohet në pajtim me këtë ligj. 2. Rregullat për organizimin e brendshëm të ministrive, sipas nënparagrafëve 1.2, 1.3 dhe paragrafit 2 të nenit 15, si dhe neneve 19 deri 21 të këtij ligji, zbatohen për organizimin e brendshëm të Agjencisë Ekzekutive dhe Agjencisë Rregullatore, në përputhje me nivelin e organizimit, përcaktuar sipas paragrafit 1 të këtij neni.*

Pra, referuar përcaktimit ligjor si më sipër dhe bazuar në shkresat e lëndës rrjedhë së Inspektorati Qendror i Punës udhëhiqet nga Kryeinspektori respektivisht Drejtori Ekzekutiv, si pozitë a kategorisë së lartë drejtuese siç parashihet me nenin 38 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, duke pasuar në organizmin sipas strukturës Zëvendës kryeinspektor/ Departamente/Divizione/Njësi Regjionale.

Në kuptim të themelësisë së pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit bazuar në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil ka analizuar aktin e kontestuar me ankesë në ndërlidhje me legjislacionin në fuqi që rregullon institutin e ushtruesit të detyrës, gjegjësisht nenin 35 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, me të cilin përcaktohet se: *1. Në rast se një pozitë e nivelit drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësja/i i nivelit të lartë drejtues e atij institucioni e cakton me vendim ushtruesin/in e detyrës për pozitën e lirë. 2. Në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, ushtruesja/i i detyrës mund të caktohet zyrtarja/imë i lartë i kategorisë pasuese, në vartësi të pozitës që caktohet, nga cilado njësi organizative brenda institucionit..*” si dhe nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet: *1. Paragrafi 1. i nenit 35 të ligjit bazik ndryshohet si në vijim: 1. Në rast se një pozitë e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësi i nivelit të lartë drejtues i atij institucioni e cakton me vendim ushtruesin e detyrës për pozitën e lirë. Për kategorinë e nivelit të lartë drejtues, ushtruesin e detyrës e cakton titullari...dhe si rrjedhojë duke u bazuar në këtë kuadër ligjor, kolegji konstaton se Vendimi Nr.11-2/2025 i datës 16.07.2025, i Ministrisë së Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, është nxjerr në kundërshtim me dispozitat ligjore, mbi arsyet se ushtrues detyre në pozitën e Drejtorit Ekzekutiv të IQP-së nuk është caktuar nëpunësi civil i kategorisë pasuese, rrjedhimisht sipas Aktit të Emërimit të datës 07.04.2022, nëpunësi civil Riza Plakolli është i emëruar në pozitën e punës Zyrtar Shpenzues dhe i Pasurisë, klasa profesionale 2, andaj, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit emërimi i nëpunësit civil Riza Plakolli në pozitën e ushtruesit të detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të IQP-së sipas Vendimit Nr. 11-2/2025 të datës 16.07.2025, bie ndesh me nenin 35 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, dhe si i tillë vendimi i kontestuar ia cenon ankueses të drejtën e caktimit si ushtrues të detyrës në pozitën përkatëse, për shkak se pozita e ankueses si Drejtor për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme konsiderohet si pozitë e kategorisë pasuese (me mungesë të zëvendës drejtor ekzekutiv), konkretisht pozita e ankueses është me e lartë se pozita e nëpunësit të emëruar i cili mbanë pozitë të kategorisë profesionale, por kjo nuk nënkupton domosdo emërimin e ankueses në pozitën përkatëse nëse brenda organit përkatës të punësimit ekzistojnë pozita të nivelit të njëjtë me pozitën e ankueses, ngase në rrethanat e tilla kur disa nëpunës civil gjenden në pozitë të nivelit të njëjtë caktimi i ushtruesit të detyrës mbetet në diskrecion të titullarit të institucionit.*

Nisur nga konstatimi si me sipër së akti i kontestuar është nxjerrë më shkelje ligjore, atëherë, çdo akt i nxjerr në kundërshtim me dispozitat materiale është akt i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që, në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, rrjedhimisht aprovoj ankesën e ankueses, anuloi vendimin Nr. 11-2/2025 të datës 16.07.2025, të Ministrit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve dhe obligoj këtë të fundit, që me rastin e emërimit të ushtruesit të detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të IQP-së të ketë parasysh kërkesat ligjore të përcaktuara me nenin 35 të Ligji Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, në kuptim të respektimit të kushteve dhe kriterëve përkatëse.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.1390/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses N.S;
- Ministrit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Inspektoratin Qendror të Punës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.